



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E DREJTËSISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT  
DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 340 prot.

Tiranë, më 26.02 2026

**NJOFTIM PËR POZICIONIN VAKANT "MAGAZINIER, SEKTORI I BUXHETIT,  
FINANCËS DHE SHËRBIMEVE NË ZYRËN PËRMBARIMORE GJYQËSORE  
TIRANË.**

Në mbështetje të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjit nr. 8 /2023 "Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror", Urdhërit të Kryeministrit Nr. 117, datë 26.08.2025 "Për disa ndryshime në Urdhërin nr.222, datë 14.12.2023 të Kryeministrit, "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror", Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit shpall në faqen zyrtare të DPP njoftimin për personat e interesuar për pozicionin:

**1 (një) Magazinier Sektori I buxheti, finance dhe Shërbimeve, Zyra Përmbarimore  
Gjyqësore Vendore Tiranë.**

- Kategoria e pagës: Klasa IV (sipas VKM nr. 326, datë 31.05.2023, i ndryshuar)
- Lloji i punës: Punë me kohë të plotë (8 orë në ditë, me afat të caktuar)

**Detyrat kryesore:**

- a) Administron dhe dokumenton lëvizjen e vlerave materiale dhe harton dokumentacionin përkatës, lëshon fletëhyrje, pasi të jetë bërë më parë verifikimi fizik i sasisë, i cilësisë dhe i çmimit;
- b) Evidenton në kartelat e magazinës fletë-hyrjet dhe fletë-daljet dhe bën rakordimin e tyre me kartelat e llogarisë;
- c) Ndan sipas planit dhe normativave të miratuara karburantin dhe çdo muaj përpilon pasqyrën përmbledhëse të shpërndarjes;
- ç) Evidenton mallrat me qarkullim të ngadalshëm dhe informon për to;

d) Për mallrat me përdorim të gjerë, informon vazhdimisht mbi gjendjen e tyre në magazinë duke bërë parandalimin e mungesës së tyre;

dh) Përgjigjet për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe sistemimin e vlerave materiale që ka në ngarkim;

ë) Gjatë kryerjes së detyrës, lidhur me administrimin, ruajtjen dhe dokumentimin e vlerave materiale, mban përgjegjësi sipas kuadrit ligjor në fuqi;

e) Kryen daljen e aktiveve nga magazina mbi bazën e urdhër-dorëzimit, fletë kërkesës, planit të shpërndarjes së kartelës limit dhe dokumentohet me fletëdaljen ose me dokument tjetër të njehsuar me të sipas specifikave të aktiveve;

f) Dorëzon të nëpunësi përgjegjës për financat e njësisë nga një kopje origjinale për fletëhyrjet, faturën e furnizuesit (shitësit), si dhe fletëdaljen, si dhe hedh në kartelat e magazinës lëvizjet përkatëse në sasi dhe në vlerë sipas afateve të përcaktuara nga njësitë publike në funksion të specifikës së aktivitetit të tyre;

gj) Çdo muaj mbahet procesverbal mbi përcaktimin e gjendjes së vlerave monetare në arkë, letrave me vlerë midis nëpunësit zbatues dhe punonjësit me përgjegjësi materiale.

#### **I. Kushtet që duhet të plotësojnë kandidati:**

1. Të jenë shtetas shqiptar;
2. Të kenë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të zotërojnë gjuhën shqipe në të folur dhe të shkruar;
4. Të jenë në kushtet shëndetësore që lejojnë kryerjen e detyrave përkatëse;
5. Të mos jenë të dënuar me vendim të formës së prerë;
6. Të kenë zotërojnë minimalisht diplomën e Arsimit të Mesëm të Lartë.
7. Të kenë aftësi të mira komunikuese.
8. Të respektojnë etikën dhe komunikimin me qytetarët që drejtohen pranë institucionit;
9. Të mos ketë masë disiplinore në fuqi ose të mos jetë larguar me masë disiplinore "Shkarkim nga detyra" që nuk është shuar sipas ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës Republikës së Shqipërisë".

#### **II. Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit:**

1. Kërkesë për aplikim për pozicionin;
2. Curriculum Vitae
3. Fotokopje e noterizuar e diplomës së Arsimit të Mesëm/të Lartë. .



4. Çdo dokument tjetër që vërteton , trajnime , kualifikime , vlerësime pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj
5. Fotokopje e noterizuar e librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën e punës).
6. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
7. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
8. Vërtetim i gjendjes gjyqësore.
9. Vërtetim nga Prokuroria e Rrethit, që nuk ka çështje penale në ngarkim.
10. Vërtetim nga Gjykata e Rrethit, që nuk ka çështje penale në ngarkim.
11. Vërtetim për detyrimet përmbartimore.

### **REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT.**

Në datën **06.03.2026**, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit do të njoftojë elektronikisht kandidatët që plotësojnë kushtet dhe kriteret për kualifikim.  
Si dhe në të njëjtën datë do të njoftohen edhe kandidatët që nuk plotësojnë kriteret e pranimit në mënyrë elektronike për shkaqet e moskualifikimit.

Dokumentat duhet të dorëzohen dorazi ose nëpërmjet postës zyrtare në Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbartimit me adresë sheshi. “Mustafa Qemal Atatürk”, Njësia Administrative nr. 7, kryqëzimi 21 dhjetorit, Tiranë, deri në datën **05.03.2026**.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

Ergys Qirici

